



# PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE 2021 - 2023





# PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE 2021 - 2023



# Tabela e Përmbajtjes

<b>Vendim</b>	<b>4</b>
<b>Shkurtime</b>	<b>5</b>
<b>Pjesa I: Konteksti Strategjik</b>	<b>7</b>
<b>1. Hyrja dhe qëllimi</b>	<b>7</b>
<b>2. Konteksti i Reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional</b>	<b>8</b>
2.1 Konteksti i përgjithshëm	8
2.2 Kuadri ligjor	9
2.3 Kuadri institucional	11
<b>3. Vizioni dhe parimet e përgjithshme</b>	<b>11</b>
3.1 Vizioni	11
3.2 Parimet	12
<b>Pjesa II: Qëllimet e Politikës dhe Objektivat e Veçantë të Kuadrit Strategjik</b>	<b>13</b>
<b>2.1 Qëllimi i politikave të PKV</b>	<b>13</b>
2.1.1 Qëllimi i politikës I: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	14
2.1.2 Qëllimi i politikës II: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë	15
2.1.3 Qëllimi i politikës III: Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	17
<b>Pjesa III: Zbatimi, Përgjegjësia e Institucioneve, Llogaridhënia, Raportimi dhe Monitorimi</b>	<b>21</b>
<b>3.1 Zbatimi i PKV Antitrafikim</b>	<b>21</b>
<b>3.2 Monitorimi dhe raportimi</b>	<b>21</b>
<b>Pjesa IV: Analiza Buxhetore</b>	<b>22</b>
<b>Aneks 1: Tabela e PKV-së Antitrafikim</b>	<b>26</b>
<b>Lista e Indikatorëve/Treguesve të Dokumenteve Strategjike</b>	<b>39</b>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
VENDIM**

**Nr. 670, datë 10.11.2021**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1140, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,  
"PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA  
2021–2025 DHE PLANIN E VEPRIMIT 2021–2022"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet shtojca 1, me titull "Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2023-2021", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Mjedisit dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTËR  
EDI RAMA**

**MINISTRI I BRENDSHËM  
Bledar ÇUÇI**

# Shkurtime

<b>AMA</b>	Autoriteti i Mediave Audiovizive
<b>AP</b>	Autoriteti Përgjegjës
<b>ASHDMF</b>	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
<b>ASCAP</b>	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
<b>DPAP</b>	Drejtoriae Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
<b>DPD</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DPAP</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
<b>DPPSH</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
<b>DSHSB</b>	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki
<b>DVKM</b>	Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin
<b>DRSHSSH</b>	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
<b>ICITAP</b>	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
<b>ICMPD</b>	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
<b>KB/UN</b>	Kombet e Bashkuara
<b>KK</b>	Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave
<b>KRAT</b>	Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave Komitetet Rajonale Antitrafikim
<b>KSH</b>	Komiteti Shtetëror
<b>KKSAT</b>	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik
<b>MB</b>	Ministria e Brendshme
<b>MKR</b>	Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit
<b>MEPJ</b>	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>MAS</b>	Ministria e Arsimit dhe Sportit
<b>MTM</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<b>MKR</b>	Mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal
<b>MMDHF</b>	Mekanizmi i Mbrojtjes ndaj Dhunës së Fëmijëve
<b>NJMF</b>	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
<b>NJL</b>	Njësi Lëvizëse
<b>OJF</b>	Organizata Jofitimprurëse
<b>ON</b>	Organizata Ndërkombëtare
<b>PKK</b>	Pika e Kalimit Kufitar
<b>PMF</b>	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve
<b>PSV</b>	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit

<b>SHSSH</b>	Shërbimi Social Shtetëror
<b>AKPA</b>	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
<b>SPZ</b>	Specialisti i policisë së zonës
<b>TQNJ</b>	Trafiku i Qenieve Njerëzore
<b>UNODC</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat
<b>VT</b>	Viktimë trafikimi
<b>VMT</b>	Viktimë e mundshme trafikimi
<b>ZKKA</b>	Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave



# Pjesa I: Konteksti Strategjik

## 1. Hyrja dhe qëllimi

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023 është një instrument që synon koordinimin e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë, përfshirë organizatat ndërkombëtare, të angazhuar në luftën kundër trafikimit të personave. PKV bazohet në planin e mëparshëm, që mbulonte periudhën 2018-2020, si dhe në Raportin e Monitorimit për zbatimin e PKV 2018-2020, i cili ofron një analizë të detajuar të nivelit të realizimit të masave të parashikuara, fazën në të cilën ndodhet zbatimi i tyre si edhe rekomandime dhe sugjerime për periudhën vijuese. Rekomandimet e organizmave dhe organizatave ndërkombëtare në lidhje me situatën e trafikimit të personave janë përfshirë përse është e mundur dhe e realizueshme përgjatë periudhës 2021-2023.

Ky dokument reflekton edhe praktikën më të mira ndërkombëtare si dhe situatën e kohëve të fundit që lidhet me pandeminë, përse i përket faktorëve nxitës të trafikimit dhe formave të shfaqjes së tij, duke qënë se trafikimi i qenieve njerëzore përfshin si vendet fqinje dhe vendet anëtare të BE dhe ka tipare të ngjashme në të gjitha vendet pavarësisht diferencave që ato kanë nga pikëpamja sociale, ekonomike dhe kulturore.

Trafikimi i personave në Shqipëri mbetet ende një fenomen shqetësues, i cili mund të trajtohet vetëm në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale, ku do të përfshihet një gamë e gjerë e aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë të cilët duhet të ndërveprojnë në mënyrë të koordinuar dhe efektive.

Plani i Veprimit përbën dokumentin më të rëndësishëm politik dhe strategjik të vendit në fushën antitrafikim. Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën

kundër Trafikimit të Personave 2018-2020, por të përshtatura me dinamikën e trafikimit, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirë orientuar synimesh e objektivash strategjike në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Po ashtu, miratimi i këtij dokumenti është një nga masat e parashikuara në Planin Kombëtar të Integritit Evropian (PKIE) në kuadër të angazhimeve të Ministrisë së Brendshme, si në nivel kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018-2020 ishte një plan gjithëpërfshirës me 143 masa konkrete dhe aktorë të identifikuar dhe ngarkuar me detyra konkrete për zbatimin e tij. Sipas vlerësimeve të Raportit të Monitorimit për zbatimin e PKV 2018-2020, ka rezultuar se janë realizuar plotësisht 125 masa që përfaqësojnë 87.4%, janë pjesërisht të realizuara dhe në proces 8 masa që përfaqësojnë 5.6% ndërkohë që 10 masa janë të porealizuara që zënë 7%.

PKV 2021-2023, i cili bazohet ngushtësisht mbi raportin e monitorimit, përfshin masat e porealizuara dhe ato të realizuara pjesërisht, si edhe përfshin masa të cilat janë raportuar të realizuara por që konsistojnë në objektiva e veprimtari të cilat janë aktuale në çdo kohë, të tilla si: ndërgjegjësimi, ngritja e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, bashkërendimi i ndërhyrjeve dhe financimi i tyre i përshtatshëm. Me qëllim të hartimit të një plani gjithëpërfshirës, aktual, të realizueshëm dhe konform detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka edhe në planin ndërkombëtar, janë analizuar dhe marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të organizatave ndërkombëtare përse i përket situatës së trafikimit të personave në Shqipëri dhe, konkretisht: Progres Raporti i BE, Këshilli i Evropës (GRETA) dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat.

PKV, së bashku me objektivat specifike dhe masat, reflektojnë për sa është e mundur edhe zhvillimet në nivelin evropian lidhur me zbatimin e direktivave antitrafik dhe paralajmërimit të Europol, për sa i përket efektit të situatës së pandemisë në rritjen e mundshme të rrezikut për shfrytëzim seksual dhe në punë.

## 2. Konteksti i Reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

### 2.1 Konteksti i përgjithshëm

Synimi strategjik i këtij dokumenti është realizimi i një sistemi të integruar të adresimit të të gjitha hallkave dhe elementeve që lidhen me trafikimin e personave dhe pasojat e tij, i cili bazohet në ndërveprimin efektiv institucional, brenda e jashtë vendit dhe bashkërendimin e veprimtarive. Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike, që adresojnë çështjet e krimit të organizuar. Një nga prioritetet kryesore në Programin e Qeverisë Shqiptare dhe prioritetet e Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, duke parashikuar këtu luftën kundër krimit të organizuar e trafikeve të paligjshme.

Sikurse parashikohet dhe në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 vlerësohet i domosdoshëm miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023, duke qenë se trafikimi i personave:

- është një fenomen kompleks që shkon përtej luftës kundër krimit të organizuar dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të njeriut;
- është një fenomen që kërkon një qasje të fokusuar, gjithëpërfshirëse, më të gjerë se forcimi i aspekteve të hetimit dhe ndjekjes penale;
- kërkon garanci parandaluese dhe partneritet, mbrojtje dhe asistencë për viktimat e trafikimit, garanci që i jep një përqasje specifike, të veçantë dhe multidimensionale.

Plani Kombëtar i Veprimit bazohet në një analizë të përgjithshme mbi situatën aktuale të trafikimit në Shqipëri që identifikon faktorët determinues që qëndrojnë në themel të trafikimit, si dhe grupet më të prekura të shoqërisë, si gratë/vajzat, fëmijët dhe komunitetet etnike Romë dhe Egjiptianë. Krahas renditjes së disa prej arritjeve më të rëndësishme gjatë periudhës 2018-2020, në Planin e Veprimit identifikohen si fusha që synohet të përmirësohen gjatë zbatimit të këtij plani:

- garantimi i përputhjes së legjislacionit kombëtar penal dhe procedural penal mbi trafikimin e personave me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;
- forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale (qasja, aksesimi në drejtësi);
- përmirësimi i reagimit nga policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësor në drejtim të zbatimit rigoroz të ligjeve në fuqi, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, zhvillimit të procesit gjyqësor dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit;
- sigurimi i identifikimit fillestar dhe referimeve për mbrojtje të fëmijëve dhe të rriturve si viktimat/viktima të mundshme trafikimi për qëllime shfrytëzimi dhe referimi i menjëhershëm i tyre pranë shërbimeve të duhura të asistencës, bazuar në nevojat individuale në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të);
- garantimi në vazhdimësi i funksionimit efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të;
- garantimi dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit (fëmijë dhe të rritur në qendra ose jashtë, përfshirë asistencë sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore, si dhe garantimi i respektimit të standardeve kombëtare të përcaktuara dhe PSV-ve;
- nxitja e kthimit dhe riintegrit, si dhe përfshirjes sociale të të miturve dhe të

rriturve si persona të trafikuar (VMT dhe VT) dhe ulja e rrezikut për personat e trafikuar për t'u riviktimizuar, ritrafikuar ose që të kthehen në trafikues;

- përmirësimi i parandalimit të trafikimit nëpërmjet forcimit të sistemeve mbrojtëse, krijimit të mundësive social-ekonomike dhe mundësive të tjera të jetesës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit;
- rritja e ndërgjegjësimit publik mbi të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët etj.), si dhe pasojat e tij;
- forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar;
- bashkërendimi i të gjitha masave antitrafik dhe bashkëpunimi i frytshëm mes të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit në Shqipëri dhe, veçanërisht, me Mekanizmin e Dhunës në familje dhe Sistemit të Integruar të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel qendror dhe lokal;
- përmirësimi i menaxhimit të të dhënave dhe informacionit mbi trafikimin e personave, si dhe krijimi i një mekanizmi për monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të përpjekjeve antitrafik;
- sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të veprimtarisë antitrafik.

PKV bazohet dhe del në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, për të adresuar këto qëllime të politikës:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, me objektiv specifik 1.2 "Goditja e trafikeve të paligjshme";
2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë, me objektiva specifikë 2.1 "Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar" dhe 2.2 "Rritja e profesionalizmit";
3. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, me objektiv specifik 3.1 "Realizimi i fushatave për rritjen e

ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar" dhe 3.2 "Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël".

## 2.2 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë luftën kundër trafikimit të personave përfshin:

### Legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokollin shtesë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për Shitjen e Fëmijës, Prostitucionin e Fëmijës dhe Pornografinë e Fëmijës;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ "Protokollin shtesë mbi parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve";
- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ "Protokollin kundër Kontrabandimit të Emigrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare";
- Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAW;
- Konventa e Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore";
- Konventa evropiane "Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme";
- Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore;
- Konventa e Konferencës së Hagës "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit";
- Konventa e Konferencës së Hagës "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen,

- zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”;
- Konventa e Konferencës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”;
  - Konventa e Konferencës së Hagës “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”;
  - Konventa e Konferencës së Hagës “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”;
  - Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve seksuale”;
  - Konventa e Këshillit të Evropës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”;
  - Konventa e Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”;
  - Konventa e Konferencës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” (miratuar në parim, nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 26.5.2011);
  - Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore;
  - konventat e ILO-s nr. 29 “Për punën e detyrueshme”, 138 “Mosha minimale për pranimin në punë” dhe 182 “Për ndalimin dhe veprimet e menjëhershme për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve”.

### Legjislacionin shqiptar

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi Penal, neni 110/a “Trafikimi i të rriturve”, neni 128/b “Trafikimi i të miturve”, neni 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturit”, neni 117 “Pornografia” dhe Kodi i Procedurës Penale, të ndryshuar;
- ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
- ligji nr. 108/2014, “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar;
- ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”;
- ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;

- ligji nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;
- ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar;
- ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;
- ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike”;
- ligji nr. 98/2017, “Për tarifatat gjyqësore në RSH”;
- ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;
- ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1140, datë 24.12.2020, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2021–2022”;
- vendimi nr. 195, datë 11.4.2007, i Këshillit të Ministrave, “Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale”;
- vendimi nr. 933, datë 2.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol”, i ndryshuar;
- udhëzimi i përbashkët nr. 3799, datë 8.7.2014, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”;
- urdhri nr. 805, datë 1.8. 2017, i ministrit të Brendshëm, “Për forcimin e kontrollit të

shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”;

- memorandum i mirëkuptimit, i Ministrisë së Brendshme, i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe i Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë në Shqipëri (OSCE) “Për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm” (nënshkruar në vitin 2007);
- marrëveshja e bashkëpunimit për funksionimin e mekanizmit kombëtar të referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave (MKR), datë 15 qershor, 2012.

Plani i Veprimit angazhon me detyrime një numër të gjerë institucionesh dhe agjencish shtetërore dhe jo-shtetërore, duke përcaktuar përgjegjësitë, detyrimet dhe kontributin e secilës prej tyre në parandalimin e trafikimit të personave dhe garantimin e një mbrojtjeje gjithëpërfshirëse për viktimat e trafikimit. PKV ruan frymën e një bashkëveprimi të ndërsjellë të krijuar tashmë ndërmjet të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë dhe synon forcimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij nëpërmjet aplikimit të një politike të hapur, proaktive dhe gjithëpërfshirëse. Një pjesë e mirë e aktiviteteve të nisura gjatë zbatimit të PKV 2018-2020, parashikohen të konsolidohen dhe fuqizohen më tej në Planin e Veprimit 2021-2023. Shembujt dhe praktikat e mira janë shprehur në aktivitete konkrete dhe të matshme.

### **2.3 Kuadri institucional**

Sipas VKM nr.604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, MB është është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës që bashkërendon punën për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit dhe riintegrimin e tyre.

Zbatimi i këtij plani veprimi bazohet në bashkëpunimin e shumë aktorëve shtetërorë ku rol më të spikatur ka Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë dhe përfshin një listë të gjerë aktorësh të tjerë shtetërorë si dhe është planifikuar të realizohet në bashkëpunim dhe me aktorë jo-shtetërorë që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe organizata jo-fitimprurëse që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e antitrafikimit dhe adresimit të faktorëve nxitës të tij.

Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, që janë përgjegjëse dhe/ose bashkëpunojnë me Ministrinë e Brendshme për zbatimin e planit dhe për të shkëmbyer informacion janë:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- komitetet rajonale antitrafikim;
- njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

### 3. Vizioni dhe parimet e përgjithshme

#### 3.1 Vizioni

Përgjatë gjithë dokumentit strategjik përçohet vizioni se, trafikimi i personave mund të parandalohet me sukses vetëm nëpërmjet fuqizimit social dhe ekonomik të grupeve dhe personave në nevojë, zbatimit efikas të ligjit dhe ndëshkimit të shkelësve, si dhe fuqizimit të shërbimeve dhe kapaciteteve në ndihmë të personave të trafikuar, qofshin këta viktimat apo viktimat të mundshme të trafikimit. Gjithashtu, ngritja e mekanizmave bashkërendues duke filluar nga niveli bazë do të mundësonte qëllimin përfundimtar të çdo nisme antitrafik, që është identifikimi i çdo viktime trafikimi për t'i dhënë ndihmën, mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme për një riintegrim efektiv dhe të qëndrueshëm në shoqëri.

PKV bazohet në vizionin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe, në veçanti synon të sigurojë që *qeveria shqiptare dhe të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë janë të angazhuar dhe përkushtuar për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e personave dhe për të siguruar mbrojtjen e individëve dhe grupeve vulnerabël nga trafikimi, marrjen e masave efektive ligjore ndaj autorëve të krimit të trafikimit të personave, si dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe, veçanërisht, fëmijëve e grave.*

Ky vizion është në përputhje dhe me vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim "Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë", në lidhje me objektivat e parashikuara për krijimin e një mjedisi të sigurt

për shoqërinë, uljes së trafikimit të paligjshëm dhenë veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë, si dhe krijimin e një shërbimi hetimor bashkëkohor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

Misioni i PKV është promovimi i një reagimi efektiv, adekuat dhe të bashkërenduar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave të bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkëpunimin efektiv ndër-institucional brenda vendit, pjesëmarrjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe përfshirjen së shoqërisë civile dhe komunitetit.

#### 3.2 Parimet

Ky plan veprimi mbështetet në parimet e mëposhtme:

*Përgjegjësia shtetërore:* Shteti ka përgjegjësi të marrë masa për të reaguar dhe përgjigjur ndaj situatës së trafikimit në kohë, me efektivitet, në mënyrë gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

*Respektimi i të drejtave të njeriut është konsideratë parësore:* Të drejtat e personave të trafikuar duhet të jenë në qendër të të gjitha përpjekjeve për të parandaluar e luftuar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat. Masat antitrafik nuk duhet të ndikojnë negativisht tek të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i personave dhe veçanërisht tek viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.

*Sigurimi i mbështetjes efektive të viktimave të trafikut/viktimave të mundshme të trafikut:* Mbështetja e viktimave dhe të mbijetuarve të trafikimit bazohet në një qasje holistike, të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, të përshtatur nga pikëpamja kulturele, që ka në qendër viktimat dhe konsideron efektet e traumës.

# Pjesa II: Qëllimet e Politikës dhe Objektivat e Veçantë të Kuadrit Strategjik

## 2.1 Qëllimi i politikave të PKV

PKV bazohet dhe del në zbatim të Strategjisë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe për më shumë reflekton gjetjet dhe rekomandimet e Raportit Global të vitit 2021 të Departamentit Amerikan të Shtetit për Trafikimin e Personave<sup>1</sup>. Ky raport edhe pse vlerëson përpjekjet e shtuara të ndërmarra nga vendi ynë në luftën kundër trafikimit të personave vë në dukje se nuk janë arritur standardet minimale për eliminimin e trafikimit në disa fusha kyçe si ndjekja penale, mbrojtja e VT/VMT, parandalimi dhe profilizimi i trafikimit.

Bazuar në këto gjetje, prioritizimet e rekomanduara në raport si dhe në një qasje shumëdimensionale dhe të koordinuar, fushat kryesore të këtij plani kombëtar veprimi janë:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda nëpërmjet ndryshimeve të legjislacionit penal dhe adoptimit të një ligji të veçantë kundër trafikimit dhe për mbrojtjen e VT/VMT duke përafuar dhe legjislacion të BE në këtë fushë. Për më shumë realizimi i këtij objektivi do të mbështetet nga veprimtari trajnuese të strukturave ligjzbatuese, veprimtari koordinuese mes tyre për kryerjen efektive të hetimeve dhe veprimtari monitoruese. Një rëndësi i është kushtuar trajnimit të strukturave të vijës së parë me qëllim identifikimin proaktiv të viktimave.

2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat dhe format e disponueshme të mbështetjes së VT/VMT, trajnimit të profesionistëve dhe strukturave mbështetëse për mbrojtjen sociale dhe riintegrimin e qëndrueshëm të tyre në shoqëri. Mbrojtja e viktimave është bazuar në një qasje që ka në qendër viktimën dhe garanton mbrojtjen përshtatshme të tyre nëpërmjet ndihmës juridike, psikologjike me një fokus të veçantë nëshëndetin mendor, kujdesit shoqëror dhe riintegrimin ekonomik. Për më shumë, shkëmbimi efektiv i informacioneve dhe përditësimi i bazës së të dhënave, do të kontribuojnë në profilizimin e VT/VMT dhe organizimin efektiv dhe të fokusuar të burimeve dhe mbështetjes ndaj VT/VMT.

3. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda. Ky objektivi mbështetet nga masa që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit qytetar dhe ndjenjës së përgjegjësisë së përbashkët për sigurinë në komunitet, rritjen e besimit dhe bashkëpunimit të tyre me institucionet përgjegjëse në përgjigje të përpjekjeve për identifikimin dhe parandalimin e faktorëve nxitës të trafikimit.

<sup>1</sup> <https://www.state.gov/reports/2021-trafficking-in-persons-report/albania/>

## **2.1.1 Qëllimi i politikës I: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda**

Treguesit kryesorë i rezultatit për këtë qëllim politik është

- Raporti i numrit të çështjeve për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore të referuara në prokurori dhe gjykatë përkundrejt atyre të evidentuara nga policia e shtetit.

### **Objektivi specifik 1.1: Goditja e trafikeve të paligjshme**

Masat në lidhje me këtë objektiv janë:

- 1.1.1 Ndryshimi i Kodit Penal në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të RSH dhe rekomandimet (finalizimi i miratimit të ndryshimeve ligjore për nenet 124 /b, 128/b për të parashikuar shfrytëzimin ekonomik dhe trafikimin e brendshëm të fëmijëve, edhe në kuadër të PKV për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë Fëmijët në Situatë Rruge 2019-2021), 52/a, 110/a, 114 (2) të Kodit Penal) si edhe ndryshimi për trafikimin e organeve njerëzore (sipas Konventës së Këshillit të Evropës)
- 1.1.2 Miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT dhe përafrimi për aq sa është e mundur me Direktiven 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”: Ngritja e prupit të punës; Sigurimi i ekspertizës për draftimin e ligjit; Konsultimi publik
- 1.1.3 Trajnimi i strukturave gjyqësore për t’u specializuar për veprat penale të trafikimit me qëllim për të hetuar në mënyrë proaktive rastet e trafikimit të personave, për të kryer në mënyrë efektive procedurat e ndjekjes penale, për të përdorur teknika speciale të hetimit, për të fuqizuar kryerjen e hetimeve financiare në kuadër të veprave të trafikimit, për të zbatuar sanksione proporcionale dhe

shkatërruese dhe për të siguruar që kohëzgjatja e procedurave gjyqësore të jetë e arsyeshme dhe në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe standardet e përcaktuara nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ)

- 1.1.4 Trajnimi i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësve doganorë, punonjësve të azilit dhe stafit të qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve, përfshirë stafin mjekësor për rritjen e kapaciteteve për identifikimin e VT/VMT mes azilkërkesve, migrantëve dhe veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar, pavarësisht aftësisë dhe/ose gatishmërisë së tyre për të bashkëpunuar, sidomos në situata emergjente, si në rastin e COVID-19
- 1.1.5 Trajnimi i punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë, të repartit “Shqiponja” dhe strukturave të tjera përgjigjëse për identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit për të rritur dhe fëmijë, si dhe bashkëpunimin ndërsektorial
- 1.1.6 Monitorimi dhe identifikimi i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese, të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore dhe inkurajimi i publikut për raportimin e zyrtarëve të korruptuar
- 1.1.7 Forcimi i bashkërendimit në hetimet financiare me qëllim identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta për rritjen e numrit të procedimeve penale të suksesshme
- 1.1.8 Rishikimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim, DPPSH, ISHPSHSH dhe përfshirja në të edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
- 1.1.9 Krijimi i një praktike të re koordinimi për shkëmbim informacioni periodik lidhur me evidentimin dhe referimin e çështjeve penale të trafikimit të qenieve njerëzore.



### **Treguesit në nivel masash:**

- Kodi Penal, i ndryshuar;
- ligji i veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT i miratuar;
- numri i strukturave gjyqësore të trajnuar për veprat penale të trafikimit, ndarë sipas çështjeve të trajnimeve;
- numri i viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar nga DK&M;
- numri i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësve doganorë, punonjësve të azilit dhe stafit të qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve përfshirë stafin mjekësor që kane njohuri mbi identifikimin e VT/VMT mes azilkërkuarve, migrantëve dhe veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar;
- numri i përfituesve të trajnimeve mbi identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit dhe bashkëpunimin ndërsektorial, Ndarja sipas pozicioneve: punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë; repartit "Shqiponja; struktura të tjera përgjegjëse.
- numri i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore të proceduar;
- numri i operacioneve identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe hetimeve financiare të përbashkëta të kryera;
- marrëveshja e rishikuar dhe aprovuar;
- numri i rasteve të identifikuar në lidhje me shfrytëzimin për punë, si rrjedhojë e inspektimeve të përbashkëta mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH-ja, ISHPSHSH-ja;
- praktika e re e koordinimit funksionale.

### **2.1.2 Qëllimi i politikës II: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë**

Treguesit kryesorë të rezultatit për këtë qëllim politik janë

- numri i shërbimeve të nevojshme bazë të ofruara për riintegrimin e personave të

trafikuar/rrezik trafikimi (shërbime: psikologjike, ligjore, akses në arsim/formim profesional, shërbime shëndetësore etj.) për periudhën 2021–2023;

- numri i viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar deri në fund të vitit 2023.

### **Objektivi specifik 2.1: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'ju nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar**

Masat në lidhje me këtë objektiv janë:

- 2.1.1 Informimi i VT/VMT në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT, duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit
- 2.1.2 Ndërmarrja e hapave përkatës për garantimin e mbrojtjes së posaçme dhe efektive si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut për VT/VMT, dëshmitarët dhe anëtarët e familjes së tyre, brenda apo jashtë vendit, nga hakmarrja dhe kërcënimi i mundshëm gjatë të gjitha fazave të procedimit penal duke inkurajuar rritjen e bashkëpunimit të personave të trafikuar me institucionet e zbatimit të ligjit dhe, duke aplikuar një qasje të orientuar tek mbrojtja e VT/VMT
- 2.1.3 Raportimi efektiv dhe periodik i rasteve kur ndaj VT/VMT ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT, me qëllim përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale kur janë në kushtet e mbrojtjes nga ligji, analizimin e tyre dhe vlerësimin e nevojave për trajnim të punonjësve të drejtësisë
- 2.1.4 Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes në praktikë për fëmijët/të rinjtë VT/VMT përsa i përket kompetencave të profesionistëve të përfshirë dhe mjedisit në të cilin zhvillohen intervistat, që të jetë i përshtatur e miqësor, si dhe aplikimin e mjeteve audiovizive me qëllim evitimin e intervistimit të përsëritur, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre

- 2.1.5 Hartimi i broshurave orientuese për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat jo anëtare të MKR-së, në lidhje me zbatimin e PSV-ve
- 2.1.6 Parandalimi/identifikimi i trafikimit të VT/VMT të mitur në kufi (përfshirë kalimin e paligjshëm të kufirit nga fëmijët), vetëm ose të shoqëruar me të rritur nëpërmjet kontrollit të detyrueshëm të dokumentacionit për fëmijët
- 2.1.7 Rishikimi i MKR me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar
- 2.1.8 Organizimi i takimeve periodike të anëtarëve të MKR-së
- 2.1.9 Përditësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të VT/VMT për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve nga Autoriteti Përgjegjës, si dhe raportimi periodik pranë MKR
- 2.1.10 Rishikimi i Udhëzimit të AP-së; Përfshirja në AP e përfaqësuesve nga ISHPSHSH/ AKPA/ AMSHDF; Krijimi i grupit të punës Organizimi i takimeve; Udhëzimi i rishikuar
- 2.1.11 Informimi i përshtatshëm i VT/VMT (veçanërisht për fëmijët, duke përdorur një gjuhë sa më miqësore) në lidhje me të drejtat që kanë, shërbimet në dispozicion dhe mënyrat e aksesimit të tyre, me qëllim marrjen e vendimeve të informuara nga ana e VT/VMT, si edhe informimi i vazhdueshëm i VT/VMT
- 2.2.12 Informimi i vazhdueshëm i VT/VMT për ndryshimet që ndodhin në rrethanat që prekin situatën e tyre përfshirë ndalimet, mbulimin nga media, ndryshimin e akuzave, ndërprerjen e procedurave, etj.
- 2.1.13 Sigurimi i financimit të vazhdueshëm të shërbimeve për VT/VMT me qëllim që qendrat pritëse dhe riintegruese për VT/VMT të respektojnë standardet e kërkuara
- 2.1.14 Vlerësimi i nevojave për sigurimin e strehimit, akomodimit, dhe qasjes në shërbime për VT/VMT meshkuj
- 2.1.15 Forcimi i qasjes efektive në tregun e punës për VT/VMT nëpërmjet arsimit, formimit profesional, programeve të nxitjes së punësimit dhe vetëpunësimit
- 2.1.16 Forcimi i qasjes efektive në tregun e punës për VT/VMT nëpërmjet arsimit, formimit profesional, programeve të nxitjes së punësimit dhe vetëpunësimit
- 2.1.17 Promovimi i ndërmarrjeve sociale, sipërmarrjeve të tjera sociale dhe partneritetit publik-privat në iniciativa që angazhojnë VT/VMT, përfshirë personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike
- 2.1.18 Sigurimi i efektshmërisë së Njësive Lëvizëse për identifikimin e VT/VMT, nëpërmjet zgjerimit të tyre, qoftë nga pikëpamja e përfshirjes gjeografike, ashtu dhe në rritjen e numrit të anëtarëve të NJL
- 2.1.19 Monitorimi i rasteve të fëmijëve VT/VMT, të menaxhuara nga NJMF/PMF

#### **Treguesit në nivel masash:**

- numri i rasteve të VT/VMT të asistuara në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT, duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në faze të hershme të procesit;
- numri i rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore që kanë marrë mbrojtje të posaçme;
- numri i rasteve kur ndaj VT/VMT ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT;
- raporte monitorimi mbi zbatimin e masave të mbrojtjes në praktikë për fëmijët/të rinjtë VT/VMT;
- numri i materialeve informuese të prodhuara për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat e mbrojtjes në bashki, strukturat joanëtare të MKR-së, në lidhje me zbatimin e PSV-ve;
- numri i personave të informuar në lidhje me zbatimin e PSV-ve;
- numri i të miturve VT/VMT të identifikuar gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit në PKK;
- marrëveshja për funksionimin e MKR-së e finalizuar;

- numri i problematikave/çështjeve të trajtuara në takimet periodike të MKR-së;
- numri i rasteve të reja të reflektuara në bazën e të dhënave të VT/VMT;
- udhëzimi i AP-së i rishikuar;
- numri i VT/VMT të informuar dhe që kanë përfituar nga shërbimet ndihmëse;
- numri i VT/VMT të informuar dhe që kanë përfituar nga shërbimet ndihmëse;
- standardet e riintegritit të përfunduara;
- numri i rasteve që kanë marrë paketat e shërbimeve në qendra dhe në komunitet;
- studim fizibiliteti për nevojat për strejim, akomodim dhe qasjen në shërbime për VT/VMT meshkuj;
- numri i kthimeve të asistuar VT/VMT sipas procedurave të unifikuara;
- numri i VT/VMT që kanë përfituar nga arsimi, formimi profesional dhe programet e nxitjes;
- numri i VT/VMT që janë punësuar ndarë sipas kategorive: vetëpunësuar, punësuar në sektorin privat;
- numri i ndërmarrjeve sociale dhe partneriteteve publik-privat, të cilat angazhojnë VT/VMT përfshirë shtetasit e huaje personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike të promovuara;
- numri i rasteve të identifikuar nga njësitë lëvizëse;
- numri i moniorimeve të kryera për rastet e fëmijëve VT/VMT të menaxhuara nga NJMF/PMF.

## **Objektivi specifik 2.2: Rritja e profesionalizmit**

Masat në lidhje me këtë objektiv janë:

- 2.2.1 Trajnimi i avokatëve për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT
- 2.2.2 Trajnimi i vazhduar ndërdisiplinor i profesionistëve që punojnë me fëmijët/ të rinjtë për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT
- 2.2.3 Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin në lidhje me mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar VT/VMT

përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës, ngrirjen e pasurive dhe mbështetjen e pretendimeve për kompensim të viktimave

2.2.4 Trajnimi i avokatëve të specializuar për të mbështetur VT/VMT në pretendimin e kompensimit

2.2.5 Trajnimi i grupeve të tjera profesionale përfshirë inspektorët e punës, punonjësit shëndetësorë (përfshirë punonjësit e shëndetit mendor), socialë, arsimorë dhe konsullorë në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve

### **Treguesit në nivel masash:**

- numri i avokatëve të trajnuar për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT;
- numri i profesionistëve që punojnë me fëmijët për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT;
- numri i punonjësve të drejtësisë të trajnuar për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin në lidhje me mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar VT përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës. Ndarë: prokurorë; gjyqtarë;
- numri i trajnimeve të zhvilluara;
- numri i avokatëve të specializuar për të mbështetur viktimat në pretendimin e kompensimit;
- numri i personave nga grupet profesionale të trajnuar në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve.

### **2.1.3 Qëllimi i politikës III: Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda**

Treguesi kryesorë i rezultatit për këtë qëllim politik është

- Përqindja e të rinjve, të cilët kanë njohuri mbi çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore.

**Objektivi specifik 3.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar**

Masat në lidhje me këtë objektivi janë:

3.1.1 Organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjësuese në nivel kombëtar dhe lokal për informimin lidhur me format e trafikimit të qenieve njerëzore dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin për të drejtat e VT/VMT (veçanërisht gjatë muajve Tetor, si muaj dedikuar çështjeve të antitrafikut), nëpërmjet platformave të komunikimit:

- Spote ndërgjegjësuese mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore në radio & televizion lokale dhe kombëtare;
- Fushatë ndërgjegjësimi në terren dhe online nëpërmjet faqes zyrtare të MB dhe mediave sociale në lidhje me mënyrat e shfrytëzimit dhe format e shfaqjes së trafikimit, përfshirë format e trafikimit online;
- Materiale ndërgjegjësuese të printuara që synojnë grupet vulnerabël, djemtë, vajzat e gratë, fëmijët, komunitetin rom dhe egjiptian, në zonat urbane dhe rurale

3.1.2 Forcimi i kapaciteteve të Linjës Kombëtare falas 116-006 dhe Aplikacionit "Raporto dhe Shpëto" për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet:

- Prodhimit dhe shpërndarjes së posterave informues mbi Linjën Kombëtare dhe Aplikacionin në 12 qarqe, përfshirë 61 Bashki, pikat e kalimit kufitar, qendrat informuese, etj.
- Trajnimit të punonjësve të sallës operative mbi komunikimin etik, referimin e problematikave të adresuara dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi

3.1.3 Informimi e ndërgjegjësimi i punonjësve të hotelerisë dhe turizimit për identifikimin

dhe raportimin e VT/VMT, kryesisht gjatë sezonit veror

3.1.4 Informimi dhe këshillimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit me një fokus të veçantë tek marrëdhëniet e rreme të punës edhe në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023

3.1.5 Informimi i vazhdueshëm i azilkërkuesve, migrantëve të parregullt, në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit

3.1.6 Rritja e mundësive sociale dhe ekonomike për personat që i përkasin grupeve vulnerabël nëpërmjet masave efektive integruese në kuadër të zbatimit të dokumenteve të tjera politike (PKV për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, PKV për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë Fëmijët në Situatë Rruge 2019-2021, Strategjisë Kombëtare për Arsimin dhe Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022; Strategjia e Strehimit Social 2016-2025) që synojnë arsimimin, punësimin dhe përfshirjen sociale

3.1.7 Ngritja e një qendre emergjence dhe multifunkionale në veri të vendit në bashkëpunim me partnerë joshitetërorë për riintegrimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël të shoqërisë, të riskuar nga trafikimi, përfshirë VT/VTM

3.1.8 Trajnimi i anëtarëve të Komiteteve Rajonale dhe Tryezave Teknike Antitrafikim dhe aktorëve të tjerë në nivel lokal në 12 qarqet e vendit

3.1.9 Ndërmarrja e veprimtarive edukuese dhe këshilluese për gazetarët, mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave dhe rëndësinë e trafikimit si shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë (shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, lypja, shfrytëzimi seksual, martesat nën moshë)

3.1.10 Kryerja e trajnimeve/takimeve ndërgjegjësuese për gazetarët, mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në media, si dhe respektimin e

garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të fëmijëve, si kategoria më vulnerabël

3.1.11 Rritja e ndërgjegjësimit të sektorit privat në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e bizneseve për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore në zinxhirët e tyre të furnizimit, për të mbështetur rehabilitimin dhe shërimin e viktimave në përputhje me Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (CM/Rec (2016) 3) për të drejtat e njeriut dhe biznesin, si dhe përfshirja e bizneseve në veprimtaritë riintegruese të VT/VMT

3.1.12 Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese në shkolla në lidhje me fenomenin e trafikimit, efektet e tij negative, mënyrat e parandalimit dhe raportimit dhe rëndësinë e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurtë nga nxënësit

3.1.13 Trajnimi i punonjësve të institucioneve arsimore parauniversitare (mësuesit, drejtuesit, psikologët dhe punonjës socialë, stafi mbështetës, si pastrues e punonjës sigurie etj) për zbatimin me rigorozitet të PSV, veçanërisht për identifikimin e fëmijëve/të rinjve VT/VMT

#### **Treguesit në nivel masash:**

- numri i fushatave kombëtare dhe lokale të organizuara për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë (ndarja sipas fushatave të zhvilluara në televizion dhe media sociale);
- numri i personave të informuar përmes fushatave kombëtare dhe lokale;
- numri i rasteve të raportuara nga linja kombëtare falas 116-006, dhe aplikacionit "Raporto! Shpëto" për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore. (Ndarja: nr. i raportimeve në linjën kombëtare dhe atyre në aplikacion);
- numri i operatorëve të të linjës kombëtare falas 116-006 për këshillimin dhe referimin e çështjeve të raportuara të trajnuar;

- numri i trajnimeve të zhvilluara;
- numri i fushatave të organizuara në mediet sociale për promovimin e linjës kombëtare dhe aplikacionit "Raporto dhe Shpëto!";
- numri i punonjësve të hotelierisë dhe turizmit të informuar për identifikimin dhe raportimin e VT/VMT, kryesisht gjatë sezonit veror;
- numri i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit të informuar dhe këshilluar nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit;
- numri i azilkërkuësve të informuar në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit;
- kryerja e një sondazhi që do të shërbejë edhe si baseline në lidhje me: numri i personave që i përkasin grupeve vulnerabël të integruar përmes arsimit, punësimit, dhe përfshirjes sociale". Mbi bazën e shifrës baseline të përlllogaritur do të kemi edhe rrije në % të targets;
- Qendra Multifunkionale e ngritur dhe funksionale në veri të vendit;
- numri i aktoreve antitrafik të trajnuar;
- numri i gazetarëve të medias së shkruar dhe vizive të trajnuar (ndarja sipas gazetarëve të medieve vizive dhe të shkruar);
- numri i trajnimeve me pjesëmarrjen e gazetarëve të medieve vizive dhe të shkruar të zhvilluara;
- numri i gazetarëve të trajnuar mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në media dhe respektimin dhe garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të të miturve si kategoria më vulnerabël;
- numri i bizneseve që kanë marrë pjesë në masa kundër trafikimit të qenieve njerëzore: ndarë sipas: masa parandaluese; masa për riintegrimin e viktimave;
- numri i nxënësve të përfshirë në aktivitete informuese dhe edukuese në shkolla;
- numri i stafeve arsimore të trajnuar për zbatimin me rigorozitet të PSV-së.

## **Objektivi specifik 3.2: Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël**

Masat në lidhje me këtë objektivi janë:

- 3.2.1 Përmirësimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit policor nëpërmjet një përfshirjeje më aktive në planet e veprimit operativ EMPACT në luftën kundër krimit të organizuar dhe sipas strategjisë
- 3.2.2 Finalizimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Raporterit Kombëtar të trafikimit të qenieve njerëzore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave pranë Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të personave dhe mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”
- 3.2.3 Negociimi/zbatimi i marrëveshjeve të veçanta/protokolleve shtesë për bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me parandalimin e trafikimit të të rriturve dhe të të miturve (migrantë, fëmijë të pashoqëruar, VT/VTM, fëmijë në rrezik trafikimi)
- 3.2.4 Organizimi i seminareve/trajnimeve për prezantimin e PKV 2021-2023, tek të gjithë aktorët dhe partnerët që do të përfshihen në zbatimin e tij në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për të diskutuar/informuar mbi detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse që parashikon PKV, si dhe dhënia e udhëzimeve mbi hartimin e planeve të burimeve vjetore dhe planeve të monitorimit që parashikon ky plan
- 3.2.5 Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe hartimi i raporteve periodike të monitorimit

- 3.2.6 Përditësimi i vazhdueshëm në faqen zyrtare të MB-së me aktorë dhe projekte/masa të marra në fushën antitrafikim
- 3.2.7 Vazhdimësia e raportimit nga të gjitha agjensitë zbatuese tek MB mbi veprimtaritë e tyre aktuale dhe ato të planifikuara mbi situatën dhe veprimtarinë antitrafik
- 3.2.8 Intensifikimi i rolit të Bordit Këshillimor të VT/VMT, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për politikën dhe programet për parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin
- 3.2.9 Organizimi i vazhdueshëm i takimeve me grupe bashkërenduese kombëtare për evidentimin e progresit të zbatimit të PKV-së, sipas nevojave dhe hartimin e raportit të monitorimit

### **Treguesit në nivel masash:**

- numri i aksioneve të përbashkëta policore të kryera në luftën kundër krimit të organizuar dhe sipas strategjisë;
- memorandumi i bashkëpunimit i firmosur mes palëve;
- numri i rasteve të menaxhuara bazuar në bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me parandalimin e trafikimit të të rriturve dhe të të miturve (migrantë, fëmijë të pashoqëruar, VT/VTM, fëmijë në rrezik trafikimi);
- numri i zyrtarëve publikë dhe aktorëve të tjerë të informuar lidhur me PKV 2021–2023 në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor;
- numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antitrafikim të hartuara dhe publikuara;
- numri i përditësimeve çdo vit të kryera në faqen zyrtare të ZKKA-së;
- raporte periodike vjetore me rekomandime të Bordit Këshillimor të VT/VMT;
- numri i takimeve për evidentimin e progresit të zbatimit të PKV-së sipas nevojave dhe hartimin e raportit të monitorimit të kryer.

# Pjesa III: Zbatimi, Përgjegjësia e Institucioneve, Llogaridhënia, Raportimi dhe Monitorimi

## 3.1 Zbatimi i PKV Antitrafikim

PKV Antitrafikim do të zbatohet gjatë periudhës 2021-2023. MB është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit të këtij dokumenti, mbështetur kryesisht nga DPPSH dhe nga disa institucione të tjera.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë plan veprimi janë paraqitur në Planin e Veprimit (Format II). Në Planin e Veprimit janë përcaktuar gjithashtu afatet kohore, kostot indikative, burimet e financimit për zbatimin e tij dhe hendeku financiar. Për secilën nga masat është parashikuar institucioni përgjegjës për zbatimin e veprimtarisë dhe raportimin e saj. Për zbatimin e masave të parashikuara në PKV Antitrafikim do të bashkëpunohet me disa nga ministritë e linjës, institucionet e zbatimit të ligjit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile.

## 3.2 Monitorimi dhe raportimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të ngarkuara për zbatimin e tyre konsiderohet i nevojshëm për të analizuar situatën reale gjatë dhe për të mbikëqyrur ecurinë periodike, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive, në kohë dhe sipas targeteve të përcaktuara.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të kalojë përmes disa fazave si: mbledhja e të dhënave; analizimi i të dhënave; hartimi i raporteve periodike në nivel institucioni. Të gjithë institucionet të ngarkuara me zbatimin e Planit të Veprimit do të hartojnë raporte të unifikuara 6-mujore në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Drejtorja e Antitrafikut dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme do të jetë institucioni përgjegjës, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij plani veprimi.

Raportet vjetore të monitorimit dhe vlerësimit do të paraqiten për rekomandime edhe pranë Komitetin Shtetëror kundër Trafikimit.

## Pjesa IV: Analiza Buxhetore

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen e kostove indikative dhe burimeve financiare që financojnë masat e PKV kundër trafikimit të personave 2021-2023. Efektet financiare janë përlogaritur për çdo masë bazuar në aktivitetet që janë të parashikuar në Planin e Veprimit. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e masave.

Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin e dokumentave të tjerë kombëtarë, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 (faza e III), dhe propozimet sipas tavaneve të reja në kuadër të hartimit të PBA 2022-2024, konsultimet

me të gjitha institucionet e përfshira, si dhe në kostot historike nga zbatimi i planit pararendës. Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Kostimi i PKV është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikave të planifikimit buxhetor, duke përdorur instrumentat e rekomanduar nga IPSIS.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e PKV Antitrafikim 2021 - 2023 është **412,552,420 Lekë**, ose **3,300,419 Euro**. Kursi mesatar për referencë është përlogaritur me 125 lek për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 3 viteve të zbatimit PKV.


Qëllimi i Politikave	Natyrë/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2021-2023	Kostot e Planifikuara PBA 2021-2023 Buxheti dhe Donatorët	Hendeku Financiar 2021-2023
<b>Qëllimi i Politikës I:</b> Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	Korekte	50,677,784	47,478,584	<b>3,199,200</b>
	Kapitale	0	0	
<b>Qëllimi i Politikës II:</b> Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë	Korekte	138,302,992	132,507,000	<b>8,670,992</b>
	Kapitale	5,750,000	2,875,000	
<b>Qëllimi i Politikës III:</b> Rritja e forcës parandaluese nda kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	Korekte	214,946,644	182,012,644	<b>35,809,000</b>
	Kapitale	2,875,000	0	
<b>TOTALI (Lekë)</b>		<b>412,552,420</b>	<b>364,873,228</b>	<b>47,679,192</b>
<b>TOTALI (Euro)</b> <i>1 Euro = 125 Lekë</i>		<b>3,300,419</b>	<b>2,918,986</b>	<b>381,434</b>



Financimi i planit të veprimit do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimet kryesore. Për periudhën 2021-2023,


buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 85.0% të financimit të nevojshëm, 5% pritet të financohet nga donatorët, ndërsa 10.0% është hendek financiar.

### Kostot e PV – Ndarja e shpenzimeve




Kostot korente zënë rreth 98.0% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (2.0%) është e parashikuar për kosto kapitale.

### Natyra ekonomike e kostove te planit të veprimit



Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë:

### Kosto të lidhura me qëllimet e politikave



Qëllimi i Politikës III, pritet të ketë në terma financiare peshën më të madhe në zbatimin e strategjisë, përkatësisht 52.8 %. Qëllimi i Politikës II kap vlerën 34.9%, ndërsa Qëllimet e Politikës I kapin 12.3 % të kostos së përgjithshme të PKV.

Për masat e PKV që janë të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore

nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.

Moszbatimi i planit për mungesë fondesh mbetet një risk, por ky është i ulët pasi hendeku financiar është i ulët dhe është kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë.



## Aneks 1: Tabela e PKV-së Antitrafikim

I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT										
QËLLIMI I POLITIKËS 1: ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA										
OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1: Goditja e trafikeve të paligjshme										
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati fillimit	Afati mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/Targets		
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1.1.1	Ndryshimi i Kodit Penal në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të RSH dhe rekomandimet (finalizimi i miratimit të ndryshimeve ligjore për nenet 124 /b, 128/b për të parashikuar shfrytëzimin ekonomik dhe trafikimin e brendshëm të fëmijëve (edhe në kuadër të PKV për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë Fëmijët në Situatë Rruge 2019-2021), 52/a, 110/a, 114 (2) të Kodit Penal) si edhe ndryshimi për trafikimin e organeve njerëzore (sipas Konventës së Këshillit të Evropës)	MD	MB; MSHMS; PP; DPPSH	2021	2023	Kodi Penal i ndryshuar	0		1	
1.1.2	Miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT dhe përafrimi për aq sa është e mundur me Direktivën 2011/36 "Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre": Ngritja e grupit të punës; Sigurimi i ekspertizës për draftimin e ligjit; Konsultimi publik	MB	MD; MSHMS; MKR; AP; KKSAT; ON; OJF; Ekspertë të fushës	2021	2023	Ligji i veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT i miratuar	0			1

<b>1.1.3</b>	Trajnimi i strukturave gjyqësore për t'u specializuar për veprat penale të trafikimit me qëllim për të hetuar në mënyrë proaktive rastet e trafikimit të personave, për të kryer në mënyrë efektive procedurat e ndjekjes penale, për të përdorur teknika speciale të hetimit, për të fuqizuar kryerjen e hetimeve financiare në kuadër të veprave të trafikimit, për të zbatuar sanksione proporcionale dhe shkatërruese dhe për të siguruar që kohëzgjatja e procedurave gjyqësore të jetë e arsyeshme dhe në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe standardet e përcaktuara nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ)	SHM	MB/DPPSH; PP; KKSAT; ON/OJF	2021	2023	Numri i strukturave gjyqësore të trainuar për veprat penale të trafikimit, ndarë sipas çështjeve të trainimeve	50	60	70	80
<b>1.1.4</b>	Trajnimi i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësve doganorë, punonjësve të azilit dhe stafit të qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve përfshirë stafin mjekësor për rritjen e kapaciteteve për identifikimin e VT/VMT mes azilkërkuesve, migrantëve dhe veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar, pavarësisht aftësisë dhe/ose gatishmërisë së tyre për të bashkëpunuar, sidomos në situata emergjence, si në rastin e Covid-19.	DPPSH/ DK&M	MB/Azili; NJMF; DPD; MSHMS; ON; OJF	2021	2023	Numri viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar nga DK&M;  Numri i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësve doganorë, punonjësve të azilit dhe stafit të qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve përfshirë stafin mjekësor që kanë njohuri mbi identifikimin e VT/VMT mes azilkërkuesve, migrantëve dhe veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar	2  1500	2  1500	4  1700	6  1900
<b>1.1.5</b>	Trajnimi i punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë, të repartit "Shqiponja" dhe strukturave të tjera përgjegjëse për identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit për të rritur dhe fëmijë si dhe bashkëpunimi ndërsektorial	DPPSH/ Akademia e Sigurisë	MKR; KKSAT; OJF; ON	2021	2023	Numri i perfituesve të trainimeve mbi identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit dhe bashkëpunimin ndërsektorial Ndarja sipas pozicioneve - Punonjësve të patrullës së përgjithshme - të policisë - repartit "Shqiponja - struktura të tjera përgjegjëse	300	200	300	400
<b>1.1.6</b>	Monitorimi dhe identifikimi i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese, të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore dhe inkurajimi i publikut për raportimin e zyrtarëve të korruptuar	SHÇBA	DPPSH; OJF	2021	2023	Numri i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore të proceduar	0	0	0	0

1.1.7	Forcimi i bashkëndimit në hetimet financiare me qëllim identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta për rritjen e numrit të procedimeve penale të suksesshme	MB/DPPSH	PP; SPAK	2021	2023	Numri i operacioneve identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe hetimeve financiare të përbashkëta të kryera	1	1	2	3
1.1.8	Rishikimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit Antitrafikim mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH, ISHPSHSH dhe përfshirja në të edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	MB	ISHPSHSH; DPPSH; DPT; ON; OJF	2022	2023	Marrëveshja e rishikuar dhe aprovuar	0	-	-	1
						Numri i rasteve të identifikuar në lidhje me shfrytëzimin për punë, si rrjedhojë e inspektimeve të përbashkëta mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH, ISHPSHSH	0	0	0	3
1.1.9	Krijimi i një praktike të re koordinimi për shkëmbim informacioni periodik lidhur me evidentimin dhe referimin e çështjeve penale të trafikimit të qenieve njerëzore	MB	PP KKSAT MKR DPPSH	2022	2023	Praktika e re e koordinimit funksionale	0		1	

**I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT QËLLIMI I POLITIKËS II. MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË**

2.1 OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'ju nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar										
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline		Synimet/Targets	
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
2.1.1	Informimi i VT/VMT në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT, duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit	MB; KKSAT	MD; PP; AP	2021	2023	Numri i rasteve të VT/VMT të asistuar në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në faze të hershme të procesit.	86	85	170	250
2.1.2	Ndërmarrja e hapave përkatës për garantimin e mbrotjes së posaçme dhe efektive si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut për VT/VMT, dëshmitarët dhe anëtarët e familjes së tyre, brenda apo jashtë vendit, nga hakmarrja dhe kërcënimi i mundshëm gjatë të gjitha fazave të procedimit penal, duke inkurajuar rritjen e bashkëpunimit të personave të trafikuar me institucionet e zbatimit të ligjit dhe duke aplikuar një qasje të orientuar tek mbrojtja e VT/VMT	DPPSH	PP; KKSAT	2021	2023	Numri i rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore që kanë marrë mbrojtje të posaçme	1	1	1	2

<b>2.1.3</b>	Raportimi efektiv dhe periodik i rasteve kur ndaj VT/VMT ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT, me qëllim përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale kur janë në kushtet e mbrojtjes nga ligji, analizimin e tyre dhe vlerësimin e nevojave për trajnim të punonjësve të drejtësisë	DPPSH	PP	2021	2023	Numri i rasteve kur ndaj VT/VMT ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT	1	0	0	0
<b>2.1.4</b>	Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes në praktikë për fëmijët/të rinjtë VT/VMT përsa i përket kompetencave të profesionistëve të përfshirë dhe mjedisit në të cilin zhvillohen intervistat që të jetë i përshtatur e miqësor, si dhe aplikimin e mjeteve audiovizive me qëllim evitimin e intervistimit të përsëritur nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre	DPPSH	PMF; PP	2021	2023	Raporte monitorimi mbi zbatimin e masave të mbrojtjes në praktikë për fëmijët/të rinjtë VT/VMT	0	1	2	3
<b>2.1.5</b>	Hartimi i broshurave orientuese për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat jo anëtare të MKR, në lidhje me zbatimin e PSV-ve	MB	ASHMDF; NJVQV; MEPJ; OJF; ON; Ekspertë të fushës	2022	2023	Numri i materialeve informuese të prodhuara për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat e mbrojtjes në bashki, strukturat jo anëtare të MKR, në lidhje me zbatimin e PSV-ve.	0	0	7000	7000
						Numri i personave të informuar në lidhje me zbatimin e PSV-ve	2000	2000	2020	2040
<b>2.1.6</b>	Parandalimi/identifikimi i trafikimit të VT/VMT të mitur në kufi (përfshirë kalimin e paligjshëm të kufirit nga fëmijët), vetëm ose të shoqëruar me të rritur nëpërmjet kontrollit të detyrueshëm të dokumentacionit për fëmijët	DK&M	DPPSH; PMF	2021	2023	Numri i të miturve VT/VMT të identifikuar gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit në PKK.	3	3	5	6
<b>2.1.7</b>	Rishikimi i MKR me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar	MB	MKR; AP; OJF; ON	2022	2023	Marrëveshja për Funksionimin e MKR-së e finalizuar	0	0	1	
<b>2.1.8</b>	Organizimi i takimeve periodike të anëtarëve të MKR-së	MB	MKR; ON	2021	2023	Numri i problematikave /ceshtjeve të trajtuara në takimet periodike të MKR-së	3	3	5	7

2.1.9	Përditësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të VT/VMT për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve nga Autoriteti Përgjegjës, si dhe raportimi periodik pranë MKR	MB	AP; MKR; KKSAT	2021	2023	Numri i rasteve të reja të reflektuara në bazën e të dhënave të VT/VMT	86	85	170	250	
2.1.10	Rishikimi i Udhëzimit të AP-së; Përfshirja në AP e përfaqësuesve nga ISHPSHSH/AKPA/AMSHDF; Krijimi i grupit të punës Organizimi i takimeve; Udhëzimi i rishikuar	MB	AP; Ekspertë të fushës	2022	2023	Udhëzimi i AP-së i rishikuar	0		1		
2.1.11	Informimi i përshtatshëm i VT/VMTvecanërisht për fëmijët duke përdorur një gjuhë miqësore, në lidhje me të drejtat që kanë, shërbimet në dispozicion dhe mënyrat e aksesimit të tyre me qëllim marrjen e vendimeve të informuara nga ana e VT/VMT si edhe informimi i vazhdueshëm i VT/VMT	MSHMS	NJMF; SHSSH; KKSAT; OJF, ON	2021	2023	Numrii VT/VMT të informuar dhe që kanë përfituar nga shërbimet ndihmëse	86	85	170	250	
2.1.12	Informimi i vazhdueshëm i VT/VMT për ndryshimet që ndodhin në rrethanat që prekin situatën e tyre përfshirë ndalimet, mbulimin nga media, ndryshimin e akuzave, ndërprerjen e procedurave, etj.	DPPSH	PP	2021	2023	Numri i VT/VMT të informuar dhe që kanë përfituar nga shërbimet ndihmëse	86	85	170	250	
2.1.13	Sigurimi i financimit të vazhdueshëm të shërbimeve për VT/VMT me qëllim që qendra pritëse dhe riintegruese për VT/VMT të respektojnë standardet e kërkuara	MSHMS	MKR; SHSSH; KKSAT; ON	2021	2023	Standartet e riintegrit të përfunduara;  Numri i rasteve që kanë marrë paketat e shërbimeve në qendra dhe në komunitet	0  85		1  75		
2.1.14	Vlerësimi i nevojave për sigurimin e strehimit, akomodimit dhe qasjes në shërbime për VT/VMT meshkuj	MB	MSHMS; KSAT OJF	2021	2023	Studim fizibiliteti për nevojat për strehim, akomodim dhe qasjen në shërbime për VT/VMT meshkuj	0	0	0	1	
2.1.15	Zbatimi PSV-ve, i protokolleve shtesë dhe formateve të unifikuara për kthimin vullnetar të asistuar të VT/VMT, si dhe orientimi i NJMF-ve për plotësimin e saktë të formave dhe procedurave që përcaktojnë PSV-të.	MB	AP; MEPJ; NJMF; SHSSH; KKSAT; OJF; ON	2021	2023	Numri i kthimeve të asistuara VT/ VMT sipas procedurave të unifikuara	4	4	7	10	
2.1.16	Forcimi i qasjes efektive në tregun e punës për VT/VMT nëpërmjet arsimit, formimit profesional, programeve të nxitjes së punësimit e vetëpunësimit	MFE/AKPA	MSHMS; KKSAT; NJMF; SHSSH; Shërbimet sociale në bashki; OJF	2021	2023	Numrii VT/VMT që kanë përfituar nga arsimi, formimi profesional dhe programet e nxitjes  Numri i VT/VMT që janë punësuar: Ndarë sipas kategorive: - Vetëpunësuar - punësuar në sektorin privat	86  19	85  19	170  38	250  57	



2.1.17	Promovimi i ndërmarrjeve sociale, sipërmarrjeve të tjera sociale dhe partneritetin publik-privat në inisiativa që angazhojnë VT/VMT e personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike	MSHMS	KKSAT; OJF; NJVQV; Biznesi privat	2021	2023	Numri ndërmarrjeve sociale dhe partneriteteve publik-privat te cilat angazhojnë VT/VMT përfshirë shtetasit e huaj e personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike te promovuara	0	0	1	2
2.1.18	Sigurimi i efektshmërisë së Njësive Lëvizëse për identifikimin e VT/VMT nëpërmjet zgjerimit të tyre, qoftë nga pikëpamja e përfshirjes gjeografike, ashtu dhe në rritjen e numrit të anëtarëve të NJL	ASHMDF	KKSAT; DPPSH; NJMF; Shërbimet sociale në bashki; OJF, ON	2021	2023	Numri i rasteve të identifikuara nga njësitë lëvizëse	40	40	60	80
2.1.19	Monitorimi i rasteve të fëmijëve VT/VMT të menaxhuara nga NJMF/PMF	ASHMDF	SHSSH; NJVQV ;OJF	2021	2023	Numri i moniorimeve te kryera per rastet e fëmijëve VT/VMT të menaxhuara nga NJMF/PMF	0	5	6	7

## 2.2 OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2: Rritja e profesionalizmit

Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline		Synimet/ Targets	
		Institucioni përgjegjës	Institucioni Kontribues				2020	2021	2022	2023
2.2.1	Trajnimi i avokatëve për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT	DHKA	ON; KKSAT; OJF	2021	2023	Numri i avokatëve të trainuar për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT	20	20	30	40
2.2.2	Trajnimi i vazhduar ndërdisiplinor i profesionistëve që punojnë me fëmijët/ të rinjtë për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT	ASHMDF	Shërb. soc. në NJVQV; Nj L; GTN(Grupi Teknik Ndërsektorial në nivel bashkie); ON/ OJF	2021	2023	Numri i profesionistëve që punojnë me fëmijët për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT	61	61	61	61
2.2.3	Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin në lidhje me mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar VT/VMT përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës, ngrirjen e pasurive dhe mbështetjen e pretendimeve për kompensim të viktimave	SHM	ON; KKSAT; OJF	2021	2022	Numri i punonjësve të drejtësisë të trainuar për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin në lidhje me mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar VT përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës. Ndarë: Prokurorë; Gjyqtarë	26	26	36	45
						Numri i trainimeve të zhvilluara	6	6	7	8
2.2.4	Trajnimi i avokatëve të specializuar për të mbështetur VT/VMT në pretendimin e kompensimit	DHKA	KKSAT; ON; OJF	2021	2023	Numri i avokatëve të specializuar për të mbështetur viktimat në pretendimin e kompensimit	20	20	30	40

2.2.5	Trajnimi i grupeve të tjera profesionale përfshirë inspektorët e punës, punonjësit shëndetësorë (përfshirë punonjësit e shëndetit mendor), socialë, arsimorë dhe konsullorë në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve	ISHPSHSH, MFE	MB; MSHMS; MKR; ASCAP; MEPJ; AP; KKSAT; OJF; ON; Akademia Konsullorë	2021	2023	Numri i personave nga grupet profesionale të trainuar në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve Ndarja sipas Grupeve profesionale: - inspektorët e punës, - punonjësit shëndetësorë - punonjësit e shëndeti tmendor, - Punonjës social - Arsimitarë. - dhe konsullorë	100	60	120	160
-------	--	---------------	--	------	------	---	-----	----	-----	-----

### I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT

#### QËLLIMI I POLITIKËS III: RRIJTJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

#### 3.1 OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar

Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/ Targets		
		Institucioni përgjegjës	Institucioni Kontribues				2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
3.1.1	Organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjësuere në nivel kombëtar dhe lokal për informimin lidhur me formate trafikimit të qenieve njerëzore dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin për të drejtat e VT/VMT (veçanërisht gjatë muajve Tetor, si muaj dedikuar çështjeve të antitrafikut), nëpërmjet platformave të komunikimit: - Spote ndërgjegjësuere mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore në radio & televizion lokale dhe kombëtare; -Fushatë ndërgjegjësimi në terren dhe online nëpërmjet faqes zyrtare të MB dhe mediave sociale në lidhje me mënyrat e shfrytëzimit dhe format e shfaqjes së trafikimit, përfshirë format e trafikimit online; - Materiale ndërgjegjësuere të printuara që synojnë grupet vulnerabël, djemtë, vajzat e gratë, fëmijët, komunitetin rom dhe egjiptian, në zonat urbane dhe rurale	MB	MKR; AP; KRAT; AMA; OJF; ON; TV Kombëtare dhe Lokale	2021	2023	Numri i fushatave kombëtare dhe lokale të organizuara për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë (ndarja sipas fushatave të zhvilluara në televizion dhe media sociale)  Numri i personave të informuar përmes fushatave kombëtare dhe lokale	1  200 000 persona	1 fushatë  300 000 persona	2 fushata  600 000 persona	3 fushata  900 000 persona

3.1.2	Forcimi i kapaciteteve të Linjës Kombëtare falas 116-006, dhe Aplikacionit "Raporto dhe Shpëto" për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet: - Prodhimit dhe shpërndarjes së posterave informues mbi Linjën Kombëtare dhe Aplikacionin në 12 qarqe, përfshirë 61 Bashki, pikat e kalimit kufitar, qendrat informuese, etj. -Trajnimit të punonjësve të sallës operative mbi komunikimin etik, referimin e problematikave të adresuara dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislationit në fuqi	MB/DPPSH	KKSAT OJF, ON	2022	2023	Numri i rasteve të raportuara nga LinjaKombëtarefalas 116-006, dhe Aplikacionit "Raporto dhe Shpëto" për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore. (Ndarja: nr. I raportimeve në linjën kombëtare dhe atyre në aplikacion	0	6	16	30
							4	4	4	4
							0	1	2	3
							1			
3.1.3	Informimi e ndërgjegjësimi i punonjësve të hotelerisë dhe turizimit për identifikimin dhe raportimin e VT/VMT, kryesisht gjatë sezonit veror	MTM	MB, OJF, ON Shoqata Shqiptare e Turizmit	2021	2023	Numri i punonjësve te hotelerise dhe turizimit te informuar për identifikimin dhe raportimin e VT/ VMT, kryesisht gjatë sezonit veror	N/A	0	100	200
3.1.4	Informimi dhe këshillimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit me një fokus të veçantë tek marrëdhëniet e rreme të punës edhe në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023	MEPJ	MB ON OJF	2021	2023	Numri i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit të informuar dhe këshilluar nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit;	200 qytetarë	200 qytetarë	300 qytetarë	400 qytetarë
3.1.5	Infomimi i vazhdueshëm i azilkerkuesve, migrantëve të parregullt, në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit	MB/Drejtoria e Azilit, DK & M, QKPA, Karrec, Gërhot, Kapshtice	MKR	2021	2023	Numri i azilkerkuesve të informuar në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit	100 azil-kerkues	100 azil-kerkues	200 azil-kerkues	300 azil-kerkues
3.1.6	Rritja e mundësive sociale dhe ekonomike për personat që i përkasin grupeve vulnerabël nëpërmjet masave efektive integruese në kuadër të zbatimit të dokumenteve të tjera politikë (PKV për Integrimin e Romëve dhe Egjyptianëve, PKV për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë Fëmijët në Situatë Rruge 2019-2021, Strategjisë Kombëtarepërarsimin dhe Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022; Strategjia e Strehimit Social 2016-2025) që synojnë arsimimin, punësimin dhe përfshirjen sociale.	MSHMS MFEMAS	NJVQV; TT; KRAT; SHSSH; NJMF; DVP; KKSAT	2021	2023	Numri i personave që i përkasin grupeve vulnerabël të integruar përmes arsimit, punësimin, dhe përfshirjes sociale	N/A Kryerja e një sondazh që do të shërbejë edhe si baseline në lidhje me: Numri i personave që i përkasin grupeve vulnerabël të integruar përmes arsimit, punësimin, dhe përfshirjes sociale". Mbi bazën e shifrës baseline të përllogaritur do kemi edhe rrije në % të targets	0	5 % rritje nga vlera baseline e përllogaritur	10 % rritje nga vlera baseline e përllogaritur

<b>3.1.7</b>	Ngritja e një qendre multifunkionale në veri të vendit në bashkëpunim me partnerë joshitetërorë për riintegriimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël të shoqërisë, të riskuar nga trafikimi, përfshirë VT/VMT - Për të ofruar asistencë dhe shërbime shëndetësore, ekonomike, formim profesional dhe ngritje kapacitetesh për këto grupe vulnerabël	MB	NJVQV; ON; OJF	2022	2023	Qendra Multifunkionale e ngritur dhe funksionale në veri të vendit	0			1
<b>3.1.8</b>	Trajnimi i anëtarëve të Komiteteve Rajonale dhe Tryezave Teknike Antitrafikim dhe aktorëve të tjerë në nivel lokal në 12 qarqet e vendit	MB	KRAT; TT; OJF; ON	2021	2023	Numri i aktorëve antitrafik të trainuar Ndare sipas: Anëtarë të Komiteteve Rajonale Anëtarë të tryezave Teknike Antitrafikim Aktorë të tjerë antitrafik	220	220	440	660
<b>3.1.9</b>	Ndërmarrja e veprimtarive edukuese dhe këshilluese për gazetarët, mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave dhe rëndësinë e trafikimit si shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë (shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, lypja, shfrytëzimi seksual, martesat nën moshë).	AMA	MB; MKR; Shoqata e Gazetarëve  OJF; ON	2021	2023	Numri i gazetarëve të medias së shkruar dhe vizive të trainuar (ndarja sipas gazetarëve të mediave vizive dhe të shkruar)  Numri i trainimeve me pjesëmarrjen e gazetarëve të mediave vizive dhe të shkruar të zhvilluara. Ndarë sipas çështjeve të trajnimeve si me poshtë: 1. mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave dhe rëndësinë e trafikimit si shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë (shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, lypja, shfrytëzimi seksual, martesat nën moshë 2. mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në media dhe respektimin dhe garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të të miturve si kategoria më vulnerabël	30 gazetarë	30 gazetarë	50 gazetarë	70 gazetarë
<b>3.1.10</b>	Kryerja e trajnimeve/takimeve ndërgjegjësuese për gazetarët, mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në media si dhe respektimin e garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të fëmijëve si kategoria më vulnerabël	AMA	MKR; Shoqata e Gazetarëve; OJF; ON	2022	2023	Numri i gazetarëve të trajnuar mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në media dhe respektimin dhe garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të të miturve si kategoria më vulnerabël	30	30	50	70

<b>3.1.11</b>	Rritja e ndërgjegjësimit të sektorit privat në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e bizneseve për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore në zinxhirët e tyre të furnizimit, për të mbështetur rehabilitimin dhe shërimin e viktimave në përputhje me Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (CM/Rec (2016) 3) për të drejtat e njeriut dhe biznesin, si dhe përfshirja e bizneseve në veprimtaritë riintegruese të VT/VMT	MFE	MB	2021	2023	Numri i bizneseve që kanë marrë pjesë në masa kundër trafikimit të qenieve njerëzore: Ndarë sipas: - Masa parandaluese - Masa për ri-integrimin e viktimave	0	0	3	5
<b>3.1.12</b>	Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese në shkolla në lidhje me fenomenin e trafikimit, efektet e tij negative, mënyrat e prandalimit dhe raportimit dhe rëndësinë e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurtë nga nxënësit	MAS	MB; DPAP; KRAT; AP; OJF; ON; NJQV/NJMF/PMF; shërbimi psiko-social në shkolla	2021	2023	Numri i nxënësve të përfshirë në aktivitete informuese dhe edukuese në shkolla	900 nxënës	900 nxënës	1300 nxënës	1700 nxënës
<b>3.1.13</b>	Trajnimi i punonjësve të institucioneve arsimore parauniversitare (mësuesit, drejtuesit, psikologët dhe punonjës socialë, stafi mbështetës si pastrues e punonjës sigurie etj) për zbatimin me rigorozitet të PSV, veçanërisht për identifikimin e fëmijëve/të rinjve VT/VMT	MAS	MB; ASCAP; Shkolla e Drejtorëve; OJF	2021	2023	Numri i stafeve arsimore të trainuar për zbatimin me rigorozitet të PSV	450 staf arsimor	200 staf arsimor	300 staf arsimor	450 staf arsimor

### 3.2 OBJEKTIVI SPECIFIK 3.2: Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/ huaj për zona dhe komunitete vulnerabël

Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline		Synimet/Targets	
		Institucioni Përgjegjëse	Institucioni Kontribues				2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
<b>3.2.1</b>	Përmirësimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit policor nëpërmjet një përfshirjeje më aktive në planet e veprimit operativ EMPACT në luftën kundër krimit të organizuar dhe sipas strategjisë	DPPSH	ON	2021	2023	Numri i aksioneve të përbashkëta policore të kryera në luftën kundër krimit të organizuar dhe sipas strategjisë	1	1	2	3

3.2.2	Finalizimi i Memorandunit të Bashkëpunimit ndërmjet Raporterit Kombëtar të Trafikimit të Qenieve Njerëzore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave pranë Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Për inntensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të personave dhe mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”	MB	MEPJ; MKR	2022	2023	Memorandumi i Bashkëpunimit i firmosur mes palëve	0	0	0	1
3.2.3	Negocimi/zbatimi i marrëveshjeve të veçanta/protokolleve shtesë për bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me parandalimin e trafikimit të të rriturve dhe të të miturve (migrantë, fëmijë të pashoqëruar, VT/VTM, fëmijë në rrezik trafikimi)	MB	MEPJ; DPPSH; DK&M; ASHMDF; ON	2021	2022	Numri i rasteve të menaxhuara bazuar në bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me parandalimin e trafikimit të të rriturve dhe të të miturve (migrantë, fëmijëtë pashoqëruar, VT/VTM, fëmijë në rrezik trafikimi)	4	4	6	
3.2.4	Organizimi i seminareve/trajnimeve për prezantimin e PKV 2021-2023, tek të gjithë aktorët dhe partnerët që do të përfshihen në zbatimin e tij në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për të diskutuar/informuar mbi detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse që parashikon PKV, si dhe dhënia e udhëzime mbi hartimin e planeve të burimeve vjetore dhe planeve të monitorimit që parashikon ky plan.	MB	MKR; AP; OJF; ON  NJQV	2021	2022	Numri i zyrtarëve publikë dhe aktorëve të tjerë të informuar lidhur me PKV 2021-2023 në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor	0	0	500	
3.2.5	Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe hartimi i raporteve periodike të monitorimit	MB	KSH; MKR; Ministrinë e linjës dhe institucionet e përfshira në zbatim; ON; OJF	2022	2023	Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antitrafikim të hartuara dhe publikuara	0	1	2	3
3.2.6	Përditësimi i vazhdueshëm në faqen zyrtare të MB me aktorë dhe projekte/masa të marra në fushën e antitrafikimit	MB	MKR; AP; KRAT; OJF; ON	2021	2023	Numri përditësimeve çdo vit të kryera në faqen zyrtare të ZKKA	5	5	10	15
3.2.7	Vazhdimësia e raportimit nga të gjitha agjensitë zbatuese tek MB mbi veprimtaritë e tyre aktuale dhe ato të planifikuara mbi situatën dhe veprimtarinë antitrafik	MB	MKR; AP; KRAT; OJF; ON	2021	2023	Të ndarë sipas: Raporte vjetore/ masa të marra në fushën e antitrafikimit				

<b>3.2.8</b>	Intensifikimi i rolit të Bordit Këshillimor të VT/VMT, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për politikat dhe programet për parandalimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin	MB	KKSAT	2021	2023	Raporte periodike vjetore me rekomandime të Bordit Këshillimor të VT/VMT	0	1	2	3
<b>3.2.9</b>	Organizimi i vazhdueshëm i takimeve me grupe bashkërenduese kombëtare për evidentimin e progresit të zbatimit të PKV-së sipas nevojave dhe hartimin e raportit të monitorimit.	MB	KSH; MKR; KRAT; ON	2021	2023	Numri i takimeve për evidentimin e progresit të zbatimit të PKV-së sipas nevojave dhe hartimin e raportit të monitorimit të kryera Të ndara sipas: takime me Komitetin Shtetëror kundër Trafikimit; takime me grupe bashkërenduese kombëtar	0	0	2	4

## Lista e Indikatorëve/Treguesve të Dokumenteve Strategjike

Lloji i indikatorit	Emërtimi i Indikatorit	Lidhja me Nr e Shtyllës së SKZHI	Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI	Qëllimi i Politikës	Objektivi specifik me te cilin lidhet indikatorit/treguesi	Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Institucionet përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave	Përshkrimi i Metodologjisë		
1	Outcome	Përqindja e të rinjve, të cilët kanë njohuri mbi çështjet e Trafikimit të Qenieve Njerëzore	QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit. Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri në 2020 nëpërmjet: 2.1 rritjes së shkallës së zbulimit të krimeve për individë dhe rrjete kriminale të përfshirë në trafikun e paligjshëm;	Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias, dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar	Sondazh i zhvilluar me mbështetje të UNICEF	UNICEF	Ministria e Brendshme, Sektori Antitrafik	Të dhënat do mblidhen nëpërmjet anketave ballë për ballë me të rinj shqiptarë përfshirë të rinj nga komuniteti rom në katër qarqet e vendit: Tiranë, Shkodër, Kukës dhe Dibër. Anketat do të zhvillohen me persona të grupmoshës 15-29 vjeç gjatë muajit gusht 2020. Familjet do të përzgjidhen në mënyrë rastësore dhe vetëm një person për familje i grupmoshës 15-29 vjeç do të marrë pjesë në intervistë. Vlera e pikes fillestare per indikatorin (sondazhi i vitit 2020 zhvilluar nga UNICEF) si dhe rezultatet e sondazhit të vitit 2023 do të bazohen në një mesatare të rezultateve të dala nga sondazhet për këto nën-çështje që lidhen me njohuritë e të rinjve rreth trafikimit të qenieve njerëzore: <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Njohuri se çfarë nënkupton trafikimi i qenieve njerëzore;</li> <li>ii. Njohuri se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore;</li> <li>iii. Njohuri rreth llojeve të shfrytëzimit, që ndodh në Shqipëri dhe në vende të huaja;</li> <li>iv. Njohuri se kush është i rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore;</li> <li>v. Njohuri rreth metodave të rekrutimit të përdorura nga trafikantët dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore;</li> <li>vi. Njohuri rreth kushteve, që mund të çojnë drejt trafikimit të qenieve njerëzore;</li> <li>vii. Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore;</li> <li>viii. Njohuri rreth shërbimeve mbështetëse në dispozicion për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore</li> </ul>
2	Outcome	Raporti i numrit të çështjeve për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore të referuara në prokurori dhe gjykatë përkundrejt atyre të evidentuara nga policia e shtetit.	QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit. Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri në 2020 nëpërmjet: 2.1 rritjes së shkallës së zbulimit të krimeve për individë dhe rrjete kriminale të përfshirë në trafikun e paligjshëm;	Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	Goditja e trafiqeve të paligjshme	Policia e shtetit	Policia e Shtetit	Prokuroria	Metodologjia për mbledhjen e të dhënave për këtë indikator do të bëhet nëpërmjet modeleve të unifikuara të përgatitura nga Policia dhe Prokuroria e Përgjithshme. Policia e Shtetit mbledh të dhëna nga të gjitha Drejtoritë rajonale në lidhje me numrin e rasteve të trafikuar ose VMT të evidentuara nga ky institucion. Nga ana tjetër, Prokuroria e Përgjithshme konsolidon të gjitha të dhenat e prokurorive të rretheve gjyqësore dhe SPAK për çështjet të cilat janë referuar në gjykatë. Formula për llogaritjen e indikatorit nga SPAK është: Numri total i rasteve të referuara në gjykatë *100/ përkundrejt totalit të rasteve të regjistruara/hetuara nga SPAK, si dhe numri i të pandehurve të dërguar për gjykim, përkundrejt numrit të të pandehurve të regjistruar për hetim.



	Frekuenca e Matjes		Natyra e Indikatorit/ treguesit: Kumulativ/ Rritjes	Input Direkt ose i Përbërë	Formula e llogaritjes	Ndarja e të dhënave (për treguesit e përbërë)			Theksoni drejtimin e ndryshimit / trendit të ecurisë	Vlerat bazë		Vlera e synuar/ Targeti					Vlera e synuar/ Targeti i rishikuar	Vlera aktuale	SDG - Titulli i Qëllimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas OKB-së	Vlera e Synuar e treguesit të SDG	
	Në fillim të implementimit të planit	Në fund të implementimit të planit				rurale/ urbane	gjinia	rajone		Trend rritës	2020	40.4%	2021	-	2022	-					2023
	Në fillim të implementimit të planit	Në fund të implementimit të planit	Rrites	Përbërë	Totali i numrit të të rinjve të cilët kanë njohuri për çështjet e trafikimit të qënieve njerëzore *100/totalin e të rinjve të intervistuar.	rurale/ urbane	gjinia	rajone	Trend rritës	2020	40.4%	2021	-	2022	-	2023	10% më shumë se baseline	-	40.4%	16.2	Fundi i abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve
	Vjetore	Vjetore	Rrites	Përbërë	Numri total i rasteve të referuara në gjykatë *100/ përkundrejt totalit të rasteve të evidentuara nga policia.	Vepra penale për trafikim të personave të rritur dhe trafikim personash të mitur.	-	-	Trend rrites	2020	7%	2021	1% rritje	2022	1% rritje	2023	1% rritje	-	7%	16.2	Fundi i abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve

Lloji i indikatorit	Emërtimi i Indikatorit	Lidhja me Nr e Shtyllës së SKZHI	Qëllimi/Objektivi Strategjik në SKZHI	Qëllimi i Politikës	Objektivi specifik me te cilin lidhet indikatorit/ treguesi	Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Institucionet përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave	Përshkrimi i Metodologjisë		
3	Outcome	Numri i shërbimeve të nevojshme bazë të ofruara për ri-integrimin e personave të trafikuar/ rrezik trafikimi (shërbime: psikologjike, ligjore, akses në arsim/formim profesional, shërbime shëndetësore etj) për periudhen 2021-2023.	QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit. Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri në 2020 nëpërmjet: 2.1 rritjes së shkallës së zbulimit të krimeve për individë dhe rrjete kriminale të përfshirë në trafikun e paligjshëm;	Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë	Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik, për t'iu nënshtruar shtrengimit, dhunës, dhe frikësimit nga krimi i organizuar.	Ministria e Brendeshme	MSHMS, MAS, MFE, Koalicioni Kombëtar i strehëzave anti-trafik	Organizata Ndërkombëtare	Metodologjia për mbledhjen e të dhënave bazohet në grumbullimin e informacionit në mënyrë manuale e cila përcillet përmes raportimeve periodike në Ministrinë e Brendeshme-Sektorin e anti-trafikimit nga aktoret si MSHMS, MAS, MFE, Koalicioni Kombëtar i Strehëzave anti-trafik, Organizata Ndërkombëtare. Formula për përlogaritjen e indikatorit është: shumatore e të gjitha shërbimeve të raportuara nga institucionet për personat e trafikuar / rrezik trafikimi.
4	Outcome	Numri i viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar deri në fund të vitit 2023.	QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit. Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri në 2020 nëpërmjet: 2.1 rritjes së shkallës së zbulimit të krimeve për individë dhe rrjete kriminale të përfshirë në trafikun e paligjshëm;	Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë	Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik, për t'iu nënshtruar shtrengimit, dhunës, dhe frikësimit nga krimi i organizuar.	Ministria e Brendeshme, Sektori i Antitrafikut	Sektori i Atitrafikut		Sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Brendeshme është autoriteti përgjegjës për grumbullimin e të dhënave të raportuara nga Policia e Shtetit, Punonjësi i Mbrojtjes së fëmijëve, Koalicioni Kombëtar i Strehëzave, Organizata jo-fitimprurëse, Organizata Ndërkombëtare. Këto të dhëna raportohen në mënyrë periodike nga këto institucione. Sekretariati Teknik I konsolidon këto të dhëna në nivel kombëtar. Kjo bazohet në udhëzimin e përbashkët nr. 3799, datë 08.07.2014, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, "Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për identifikimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit". Ka një trend zbritës të progresit të këtij indikatorit kjo si rrjedhojë e punës së bërë nga shumë aktorë për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe rritjes së njohurive rreth trafikimit dhe formave të saj.

	Frekuenca e Matjes		Natyra e Indikatorit/ treguesit: Kumulativ/ Rritjes	Input Direkt ose i Përbërë	Formula e llogaritjes	Ndarja e të dhënave (për treguesit e përbërë)			Theksoni drejtimin e ndryshimit / trendit të ecurisë	Vlerat bazë		Vlera e synuar/ Targeti						Vlera e synuar/ Targeti i rishikuar	Vlera aktuale	SDG - Titulli i Qëllimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas OKB-së	Vlera e Synuar e treguesit të SDG
	Vjetore	Vjetore				Llojit te sherbimit	Grup moshë	-		2020	199	2021	5% me shume se baseline	2022	10% me shume se baseline	2023	15% me shume e baseline				
	Vjetore	Vjetore	kumulativ	Përbërë	Shumatore e të gjitha shërbimeve të raportuara nga institucionet për personat e trafikuar / rrezik trafikimi.	Llojit te sherbimit	Grup moshë	-	Trend rrites	2020	199	2021	5% me shume se baseline	2022	10% me shume se baseline	2023	15% me shume e baseline	-	199	16.2	Fundi i abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve
	Vjetore	Vjetore	kumulativ	Përbërë	Numri total i viktimave të trafikimit dhe viktimave të trafikimit mundëshme të raportuara në nivel kombëtar	Statusi Viktima te trafikimit/ VMT	Grup moshë	Gjinia	Trend zbrites	2020	86	2021	2% zbritje cdo vit	2022	2% zbritje cdo vit	2023	2% zbritje cdo vit	-	86	16.2	Fundi i abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve

